



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E ISTOGUT
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Istogut, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Edon Kabashi udhëheqës i ekipit, *Ylber Sadiku* dhe *Hysen Restelica* anëtarë, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Faruk Rrahmani*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Qeverisja e mirë.....	28
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	31
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	39
Shtojca II: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit	42
Shtojca III: Letër Konfirmimi.....	44

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Istogut për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 15/01/2019.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Istogut.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Komunës së Istogut.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se në kategorinë e investimeve kapitale ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht shpenzime në vlerë prej 183,326€ që për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime dhe subvencione dhe transfere. Po ashtu, llogaritë e arkëtueshme dhe pasuritë në Pasqyrat Financiare Vjetore ishin të nënvlerësuar, përderisa detyrimet kontingjente nuk ishin shpalosur fare në pasqyra.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:

Theksimi i Çështjes pasqyron dobësitë në kontrole për ta konfirmuar klasifikimin e duhur të shpenzimeve, regjistrimin e pasurisë dhe shpalsojet e plota në PVF.



Kryetari duhet t'i analizojë arsyet për Theksimin e Çështjes në 2018 dhe t'i identifikoj veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë në 2019, klasifikimin e shpenzimeve në kategori adekuate si dhe shpalsoje të plota për të arkëtueshmet dhe detyrimet kontigjente (shih çështjet te kapitulli 2).

Kontrollet në menaxhimin e të hyrave, obligimeve, llogaritë e arkëtueshme në fushën e prokurimit nuk kanë funksionuar si duhet prandaj nuk kanë mundur t'i parandalojnë mangësitë në këto fusha.



Kryetari duhet të aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe të përcaktoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet te kapitulli 3).

Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Kryetari duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/ progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet te kapitulli 5).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë të dobëta. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm nuk i mbështetë zhvillimet në këtë fushë.



Kryetari duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për ta ngritur efektivitetin operativ të mbështetur nga një NJAB më efektive (shih çështjet te kapitulli 4).

Përgjigja e Kryetarit

Kryetari ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me pjesën më të madhe të të gjeturave dhe konkluzioneve të auditimit. Për një pjesë janë dhënë disa sqarime dhe komente të cilat mund t'i gjeni në shtojcën II.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Istogut, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II dhe III.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Një pjesë e shpenzimeve janë buxhetuar dhe pastaj shpenzuar gabimisht në kategoritë joadekuate. Komuna ka klasifikuar gabimisht si investime kapitale 23 pagesa për projektet në vlerë prej 183,326€, të cilat sipas Udhëzimit Administrativ 2005/08 i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 158,657€, dhe subvencioneve në vlerë prej 24,669€;

- Pasuritë komunale vazhdojnë të jenë të nënvlerësuar, si pasojë e mos regjistrimit të 1,540 parcelave komunale dhe mos regjistrimit të pasurive të blera mbi 1,000€ në SIMFK në vlerë prej 202,603€. Në anën tjetër kemi mbivlerësim të pasurive për 124,911€ për shkak që ishin regjistruar si pasuri kapitale që nuk i plotësonin kriteret e pasurive kapitale e as të përmirësimeve të pasurive;
- Llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar për 196,101€. Në shpalosjet e PFV-ve nuk ishin përfshirë të arkëtueshmet për ngarkesa në afarizëm të bizneseve në vlerë 174,831€, ngarkesa për shërbime të pijeve alkoolike 8,380€, si dhe qiraja komunale me karakter të përkohshëm në vlerë 12,890€; dhe
- Detyrimet kontingjente në vlerë prej 152,019€ nuk ishin shpalosur në PFV.

Çështjet kyçe të auditimit

Komuna është e ekspozuar edhe ndaj detyrimeve kontingjente apo kontesteve, dhe vlera e tyre sipas informatave të Komunës është 152,019€. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të kreditorëve komuna pritet të ballafaqohet me vështirësi buxhetore në vitin e ardhshëm.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe

vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Planin fillestar dhe final të prokurimit; dhe
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal.

Në kontest të Pasqyrave Financiare kemi një çështje për t'i ngritur:

Te Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme dhe te Raporti i ekzekutimit të buxhetit kishte mos harmonizim në mes PFV dhe Shënimeve të SIMFK në vlerë prej rreth 6,000€.

Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet jo e saktë, nga fakti se shpalesjet nuk ishin të plota. Opinioni jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura rekomandojmë:

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Në procesin e buxhetimit të gjitha shpenzimet duhet të buxhetuar në përputhje me rregullat e thesarit (planin kontabël). Më tutje, e gjitha pasuria, përfshirë pronat duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë. Po ashtu, shpalesjet e llogarive të arkëtueshme dhe detyrimet kontingjente duhet të jenë prezantuar në mënyrë të plotë dhe saktë në PVF-të për vitin 2019.

Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Istogut kishte shpenzuar 91% të buxhetit final për vitin 2018 që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm, por një nivel jo i kënaqshëm ishte te investimet kapitale. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në arkëtimin e të hyrave në nivel më të lartë dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe.

Gjithashtu, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar keq klasifikimin e shpenzimeve, angazhimin e punonjësve me kontrata të përkohshme, anashkalimin e rregullave të prokurimit, rritjen e pagesave me vendime gjyqësore dhe vonesave për përfundimin e projekteve kapitale.

Me tutje, komuna duhet të ndërmarrë veprime për të përmirësuar menaxhimin dhe raportimin e plotë të pasurisë dhe obligimeve, çështje këto të ngritura edhe në raportin e vitit paraprak.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	10,197,776	10,532,051	9,542,940	8,853,886	8,846,553
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,016,861	8,894,563	8,568,226	7,734,102	7,865,277
Të bartura nga viti paraprak ²	0	307,748	135,406	333,027	145,246
Të hyrat vetjake ³	1,180,915	1,180,915	704,794	751,223	721,525
Donacionet e brendshme	0	29,367	15,060	35,534	24,334
Donacionet e jashtme	0	119,457	119,454	0	90,171

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 334,275€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të brendshme dhe të jashtme për 148,824€, të hyrave të bartura nga viti paraprak për 307,748€ dhe zvogëlimit me vendime qeveritare për 122,298€.

Në vitin 2018, OB ka shpenzuar rreth 91% të buxhetit final ose 9,542,940€, me një përmirësim prej 1% krahasuar me vitin 2017 (90%).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	10,197,776	10,532,051	9,542,940	8,853,886	8,846,553
Pagat dhe Mëditjet	6,021,834	5,899,536	5,861,876	5,638,899	5,675,925
Mallrat dhe Shërbimet	1,037,272	1,042,767	904,245	764,047	782,425
Shërbimet komunale	117,000	137,138	137,047	118,580	145,532
Subvencionet dhe Transferet	223,813	258,970	251,784	262,018	201,391
Investimet Kapitale	2,797,857	3,193,639	2,387,988	2,070,342	2,041,280

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxhetit final për paga dhe mëditje ishte reduktuar për 122,298€ me vendim të Qeverisë. Realizmi i buxhetit në këtë kategori ishte rreth 99%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 5,495€, shërbime komunale për 20,138€ dhe subvencione e transfere për 35,157€. Kjo rritje për këto kategori ka ardhur nga të hyrat

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

e bartura. Realizmi i buxhetit për mallra dhe shërbime ishte 87%, shërbime komunale 100% ndërsa në kategorinë subvencione dhe transfere 97%; dhe

- Buxheti final për investime kapitale ishte rritur për 395,872€. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat e bartura prej 246,957€, grantet e përcaktuara të donatorëve prej 148,825€. Pavarësisht kësaj buxheti për investime kapitale, ishte shpenzuar vetëm 75%. Vonesat kanë të bëjnë me disa projekte të filluara në fund të vitit 2018.

Çështja B1⁴ - Nivel i ulët i realizimit të buxhetit për investime kapitale

Gjetja Sfidë e mëtutjeshme e komunës mbetet niveli i ulët i ekzekutimit të buxhetit në investime kapitale, me rreth 75%, duke rezultuar më një nënshpenzim prej 805,651€ nga ajo që ishte e buxhetuar. Niveli i ulët i realizimit ishte kryesisht si rezultat i vonesave në zhvillimin e procedurave të prokurimit. Kjo ishte ndikuar edhe për shkakun që prokurimet për projekte ekzekutive ishin vonuar ose anuluar krejtësisht duke e ndikuar fillimin e prokurimeve për projekte kapitale.

Me tutje, pjesa më e madhe (75% e pagesave) e shpenzimeve kapitale ishin realizuar në tremujorin e fund vitit.

Rreziku Ekzekutimi i ulët i buxhetit redukton efektivitetin e planeve vjetore të organizatës. Mos-përmbushja e programit për investime kapitale do të rezultojë në realizimin e më pak projekteve, e kjo do të ndikoj në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit me kohë dhe në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna e Istogut ishin në vlerë 933,592€. Të hyrat janë realizuar nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja, taksa administrative, etj.

⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 ⁵ Pranimet
Të hyrat vetjake	1,180,915	1,180,915	933,592	843,036	1,061,435

Prej gjithsej të hyrave vetjake të planifikuara 1,180,915€, komuna kishte arritur të inkasoj 79%.

Komuna e Istogut kishte edhe të hyra indirekte në vlerë totale prej 165,193€. Të hyrat ishin nga dënimet në trafik prej 117,229€, gjobat e gjykatave prej 32,223€ dhe nga agjencioni i pyjeve prej 15,741€.

Çështja B2 -Menaxhimi jo adekuat i pronave komunale të dhëna me qira

Gjetja

Rregullorja nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme, në nenin 4 obligon komunën që dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme ta bëjë përmes procedurës së ankandit publik. Komuna e Istogut ka 42 prona komunale të dhëna me qira. Në vitin 2018 Komuna ka bërë një progres të lehtë në këtë drejtim pasi tetë (8) parcela i ka dhënë përmes ankandit publik. Megjithatë ne kemi vërejtur se:

- Menaxhimi i pronave të dhëna me qira mbetet sfidë për Komunën edhe në të ardhmen nga fakti se 41 qiramarrës kishin borxhe të pashlyera, madje 10 prej tyre nuk kishin paguar qiranë që nga viti 2008 dhe vazhdojnë ende t'i shfrytëzojnë pronat e komunës; dhe
- Në tri nga katër mostrat e testuara kemi vërejtur se kontratat ishin të skaduara⁶ dhe nuk ishte bërë azhurnimi i kontratave përderisa pronat vazhdojnë të shfrytëzohen nga qiramarrësit.

⁵ Pranimet për vitin 2016 përfshijnë edhe të hyrat indirekte.

⁶ Kontratat ishin 1 vjeçare dhe ishin të viteve 2014, 2015 dhe 2016.

Sipas menaxhmentit të Komunës arsyeja e kësaj sfide është fakti se në disa prona komunale ka pretendime se pronarët e tokave janë personat që ato toka i konsiderojnë si prona të tyre. Veprimet e menaxhmentit në eliminimin e këtyre kontesteve nuk ishin të mjaftueshme për ta ndryshuar gjendjen në menaxhimin e pronave të dhëna me qira.

Rreziku

Mungesa e kontrollit dhe mos aplikimi i masave adekuate pamundëson arkëtimin e të hyrave nga qiraja dhe rrit rrezikun e vjetërimit të kërkesave. Gjithashtu, edhe operimi me kontrata të skaduar privon komunën nga e drejta për arkëtimin e të hyrave dhe ndjekjen e procedurave gjyqësore në raste të mos inkasimit të borxhit me kohë.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale të bëhet vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave. Gjithashtu, duhet të shqyrtohen në mënyra aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e dakorduara janë realizuar.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë më: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin më thesar.

Buxheti final për mallrat dhe shërbimet ishte 5,899,536€. Prej tyre ishin shpenzuar 5,861,876€ apo 99% e buxhetit të planifikuar.

Çështja C2 - Menaxhim jo adekuat i të angazhuarve përmes kontratave të përkohshme**Gjetja**

Rregulla financiare 01/2013 në nenin 33 specifikon që të gjithë personat në marrëdhënie pune të paguhen përmes listës së pagave. Ligji për Shërbimin Civil nr.03/L-149 në nenin 12 përcakton se emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta”. Komuna gjatë vitit 2018 kishte të angazhuar 35 punonjës të angazhuar. Prej tyre 30 janë angazhuar me kontrata pune me kohë të caktuar bazuar në Ligjin e Punës dhe 5 prej tyre ishin me marrëveshje për shërbime të veçanta bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil. Ne kemi vërejtur se:

- Të gjithë të angazhuarit janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve edhe pse të angazhuarit me kontrata me afat të caktuar konsiderohen punonjës në marrëdhënie pune dhe pagesa duhet të jetë kryer nga kategoria e Pagave dhe Mëditjeve; dhe
- Ka një konfuzion të këto kontrata pasi që për të njëjtën pozitë angazhimi bëhet herë me ligjin e shërbimit civil e herë me ligj të punës. Po ashtu, vërehet se stafi ishte i angazhuar kryesisht për pozita të rregullta të punës.

Sipas zyrtarëve komunal, mangësitë e identifikuar, janë pasojë e mungesës së buxhetit për staf të ri për programet e përhershme dhe aprovimit të kufizuar të vendeve të punës nga Ministria e Financave (MF) krahasuar me kërkesat.

Rreziku

Mbulimi i pozitave me kontrata të përkohshme rritë rrezikun për rritje të pa planifikuar të shpenzimeve dhe mund të ndikojnë në mos realizimin e objektivave tjera të përcaktuara.

Rekomandimi C2

Kryetari, duhet të siguroj ndërprerjen e një praktike të tillë të angazhimeve dhe për të gjitha pozitat e rregullta të punës për të cilat komuna ka nevoja afatgjata kërkesat t'i adresoj me rastin e planifikimit buxhetor. Duke bërë kërkesë për rritje të stafit dhe t'i trajtoj dhe diskutoj me MF. Pagesat e tilla duhet kryer nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.

Çështja A1 - Mangësi në menaxhimin e personelit

Gjetja Komuna nuk kishte arritur ende të kompletoj dosjet e personelit në përputhje me Rregulloren Nr. 03/2011 mbi dosjet dhe regjistrin për shërbyesit civil” dhe dosjet në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Ne kemi vërejtur se:

- Dosjeve të shërbyesve civil, punonjësve të arsimit dhe shëndetësisë ju mungonin dokumentet si: çertifikata e lindjes, çertifikata e shtetësisë, çertifikata nën hetime, vendimi i pushimit vjetore dhe dëshmi tjera që kërkohen të jenë pjesë e dosjeve të personelit; dhe
- Drejtoria e Arsimit kishte punësuar dy persona në arsim, por që konkursin nuk e kishte publikuar në njërin nga mediat e shkruara ashtu siç kërkohet me Udhëzimit Administrativ 07/2017 (MPMS) në nenin 4 pikën 3, por e kishte publikuar në web-faqen e komunës.

Rreziku Mos azhurnimi i dosjeve dhe mos kompletimi me dokumentacionin e nevojshëm rrit rrezikun në menaxhim jo adekuat të stafit dhe reflekton me parregullsi dhe mungesë të informatave për stafin e punësuar.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë hapa konkret për përmirësimin e kontroleve mbi dosjet e personelit në mënyrë që të gjitha dosjet të jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm deri në fund të vitit.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra & shërbime dhe shërbime komunale ishte 1,179,905€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,041,292€ apo 88% e buxhetit të planifikuar. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për komunal, udhëtim, telekomunikim, blerje e pajisjeve, derivate dhe lëndë djegëse, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit, mirëmbajtje, dhe dreka zyrtare. Gjetjet për këtë kategori kanë të bëjnë me keq klasifikimet dhe janë të prezantuar te theksimi i çështjes.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 258,970€. Prej tyre ishin shpenzuar 251,784€ apo 97% e buxhetit të planifikuar. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve kulturore, sportive dhe ndihma momentale.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,193,639€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,387,988€ apo 75% e buxhetit të planifikuar. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime për rregullim të infrastrukturës, ndërtim i rrugëve, kanalizimit, trotuareve, mirëmbajtja e objekteve, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të pasurive kapitale.

Çështja A2 - Mungesa e projektit ekzekutues

Gjetja Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten.

Ne kemi identifikuar se në 15 kontrata pune të nënshkruara komuna nuk kishte pasur të hartuar projektin ekzekutiv, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte tek ndërtimi i rrugëve, trotuareve, kanalizimeve dhe kanaleve të ujitjes. Sipas zyrtarëve kjo ishte për shkak të vonesave për kontraktimin e shërbimeve për hartimin e projekteve ekzekutuese të cilat ishin zgjatur nga ankesat e shumta të operatorëve në procedurën e prokurimit. Ankesat në procedurën e prokurimit kanë rezultuar me mungesë të kontratës për hartimin e projekteve ekzekutive.

Rreziku Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe parallogari rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin e profesional ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me punë të mos iniciohen pa u siguruar se ekziston edhe projekti ekzekutues. Parapërgatitjet e duhura për një projekt do të kenë ndikim edhe në hartimin e specifikimeve të qarta, por edhe do të eliminohen pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë.

Çështja A3 – Tejkalim i punëve shtesë dhe mangësi tjera

Gjetja

Aneks kontratat sipas nenit 35 të LPP-së⁷ janë të lejuara deri në 10% të vlerës së kontratës origjinale. Kontrata origjinale⁸ për “Rregullimin e memorialit Ibrahim Rugova - faza e IV” ishte në vlerë prej 348,934€. Komuna kishte lidhur një aneks kontratë në vlerë prej 92,456€, që përbënte 26,5% të kontratës origjinale. Pra tejkalimi ishte për 57,563€, që ishte mbi 10%-shin e lejuar të aneks kontratës. Po ashtu, në këtë procedurë të prokurimit kemi identifikuar edhe disa mangësi si:

- Në dosjen e tenderit të OE fitues nuk ishte paraparë nënkontraktimi i punëve. Pas lidhjes së kontratës, përkatësisht me dt. 15.10.2018, OE fitues ka njoftuar komunën për nën kontraktimin e një pjesë të kontratës, që është në kundërshtim me Dosjes së tenderit - neni 4.2;
- Komuna nuk ka njoftuar KRPP-në brenda dy (2) ditëve nga data kur është marrë vendimi për aplikimin e procedurës së negociuar pa publikim që është kërkesë e nenit 20 të LPP-së;
- Kishte vonesa në realizim të kësaj kontrate nga fakti që me plan dinamik dhe kushte të veçanta të kontratës ishte planifikuar që kontrata të përfundonte në dhjetor 2018. Ne kemi vërejtur se deri në fund të shkurtit 2019 projekti nuk kishte përfunduar, dhe nuk kishte as aprovim për vazhdim të punëve apo edhe aplikim të penaleve; dhe
- Ekzekutimi i kontratës - gjatë ekzaminimit fizik, kemi identifikuar se tri pozicione nuk ishin realizuar sipas prodhuesit të kontraktuar⁹: (pozicionet të cilat nuk janë realizuar sipas prodhuesit të kontraktuar janë: B1 prej 12,780€, B2 prej 760€ dhe pozicioni C1 prej 25,800€). Menaxheri i kontratës i kishte aprovuar këto ndryshime për arsye se sipas tij ishin me karakteristika teknike të njëjta.

Rreziku

Tejkalimi i vlerës së punëve shtesë dhe mangësitë tjera të evidentuara të prokurimit në këtë projekte e deri te ekzekutimi i punëve rrisin rrezikun që projekti të mos përfundohet me kualitetin e kërkuar dhe të ketë devijime nga projekti fillestar.

⁷ Ligji i Prokurimit Publik nr. 04/L-042 me plotësime dhe ndryshime të ligjeve nr.04/L-237; nr. 05/L-068 dhe 05/L-092.

⁸ Kontrata është bashkëfinancim në mes Komunës dhe Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale.

⁹ Pozicionet ishin paraparë të jenë të prodhuesit Japonez përderisa ishin vendosur të prodhuesit Kinez

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë që në asnjë rast nuk mund të ketë tejkalime të punëve shtesë mbi 10% nga kontrata origjinale dhe në rastin e punëve shtesë menaxheri i prokurimit duhet t'i ndjek të gjitha rregullat e prokurimit që kërkohen. Po ashtu, duhet të vendoset sistemi i llogaridhënies në rastet e ndryshimit të pozicioneve (prodhuesit) dhe vonesave të punimeve të paaprovuara. Një monitorim i vazhdueshëm i menaxhimit të proceseve të prokurimit është i domosdoshëm nga menaxhmenti, në rastet e projekteve komplekse.

Çështja A4 - Mos respektim i kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit

Gjetja Në dosjen e tenderit për "Ndërtimin e rrugës Zhakovë - lagjia Hajrizaj" ishin përcaktuar kriteret që duhet të plotësohen nga tenderuesit lidhur me përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional.

Kemi evidentuar se udhëheqësi i punishtës i caktuar nga operatori e kishte diplomën të noterizuar në vitin 2016 përderisa sipas njoftimit për kontratë kërkohej që të ishte pas datës së njoftimit për kontratë. Po ashtu, fituesi nuk i kishte të noterizuara licencat për bazën e prodhimit të asfaltit dhe gurthyesin e licencuar nga Komisioni për Miniera dhe Minerale, e as marrëveshjen me operatorin për përdorim të bazës së asfaltit dhe gurthyesit, kërkesa këto të dosjes së tenderit. Kjo gjendje ishte si rezultat i neglizhencës së komisionit të vlerësimit e ofertave.

Rreziku Mangësitë në menaxhimin e procesit të prokurimit në përgjithësi, dhe vlerësimin e ofertave në veçanti mund të rezultojnë me kontrata të shpërblyera për operatorë të pa përgjegjshëm duke rritur rrezikun që kjo të reflektoj me mangësi në ekzekutimin e kontratave.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i prokurimeve përfshirë procesin e vlerësimit ushtrohen në harmoni të plotë me kriteret e vendosura dhe ofertuesit që nuk janë në përshtatshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit të mos shpërblehen me kontratë. Po ashtu të aplikohet sistemi i llogaridhënies në rastet e mos kryerjes së punëve sipas kërkesave ligjore.

Çështja B3 - Pagesa në mungesë të dëshmive të mjaftueshme**Gjetja**

Ne kemi vërejtur se janë realizuar dy pagesa pa u siguruar me dëshmi të mjaftueshme për kryerjen e shërbimeve. Pagesa në vlerë prej 4,343€ për “Mirëmbajtjen e ndriçimit publik” dhe pagesa prej 10,225€ për “Mirëmbajtjen e hapësirave publike”, janë realizuar bazuar në raportin e përgatitur nga menaxheri i kontratës për punët e kryera, sipas të cilit kompania ka bërë mirëmbajtjen e ndriçimit dhe hapësirave publike në lokalitete të ndryshme të komunës, por nuk tregohet saktësisht se në cilat rrugë janë realizuar.

Kjo gjendje ishte për shkak të një praktike jo të mirë të krijuar nga menaxherët të kontratave, ku raportet e tyre nuk ofrojnë detaje të mjaftueshme lidhur me kohën dhe vendin e realizimit të punëve/shërbimeve.

Rreziku

Pagesat në mungesë të dëshmive apo mos definimi i punëve/shërbimeve të pranuar rrit rrezikun e pagesave në mungesë të furnizimit apo furnizimit jo në përputhje me kontratën. Kjo mund të rezultojë edhe në dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e pagesave për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e punëve/shërbimeve të kontraktuara.

Çështja A5 - Ndryshime të sasive të para masës për kontratat jo kornizë

Gjetja Ndryshimet e sasive lejohen te kontratat kornizë. Në shtatë (7)¹⁰ kontrata jo kornizë kemi identifikuar se janë ndryshuar sasinë e realizuara nëpër disa pozicione, duke i rritur/zvogëluar mbi 10% sasinë e kontraktuar, por pa ndryshuar çmimin total të kontratës. Sipas menaxherëve të kontratës ndryshimet kanë ardhur kryesisht për shkak të kërkesave të komunitetit. Aprovimet për këto ndryshime nuk ishin marrë nga ZKA por vetëm nga zyrtari autorizues i programit buxhetor.

Duhet theksuar se menaxherët e projekteve nuk ishin në njohuri për kërkesat rregullative ligjore për prokurimin publik lidhur me ndryshimin e kontratave.

Rreziku Ndryshimi i paramasës dhe paralogarisë së kontraktuar pa aprovimin e zyrës së prokurimit dhe ZKA-së shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë dhe rrezikon që për shkak të ndryshimit të sasive të kontratës nuk është përzgjedhur operatori më i lirë.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë në njohuri me kërkesat e prokurimit publik, raportohet për çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës. Po ashtu, çdo ndryshim në kushtet e kontratës duhet të arsyetohet dhe aprovet nga zyra e prokurimit dhe ZKA.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

¹⁰ "Zgjerimi i infrastrukturës me destinim turizmin malor" prej 146,687.5€; "Ndërtimi i rrugëve në Vrelle", prej 59,761€; "Ndërtimi i rrugëve në Banjë", prej 45,399€; "Eliminimi i mbeturinave nga hapësirat publike" 16,590€; "Asfaltimi i rrugëve në Gurakoc" prej 35,889.5dhe "Asfaltimi i rrugës Sadri Lata - Zallq" prej 35,985.5€;"Kubëzimi i trotuareve Gurakoc - Zallq", prej 34,695€

Çështja A6 - Pagesat e ekzekutuara nga Thesari për vendimet gjyqësore / përmbarimore

Gjetja Neni 39 i LMFPP përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim.

Ne kemi identifikuar se Thesari kishte ekzekutuar në bazë të vendimeve gjyqësore pagesa në vlerë prej 162,922€ (ku 2,088€ ishte një kthim). Prej tyre borxhi kryesor ishte 141,845€ dhe shpenzime procedurale të gjykatës (përmbarimit) ishin 21,077€. Po ashtu, kjo formë e pagesave nga thesari ka ndikuar në marrjen e mjeteve nga kategoritë ekonomike jo adekuate.

Ne testuam dy pagesa në vlerë prej 119,441€, prej tyre borxhi kryesor ishte 116,016€, kurse shpenzimet e gjykatës (përmbarimit) ishin 3,425€. Sipas komunës këto ishin borxhe të bartura nga viti paraprak, mirëpo ne kemi evidentuar se këto dy fatura nuk ishin të përfshira në obligimet e papaguara të raportuara në pasqyrat financiare vjetore të vitit 2017. Avokati komunal nuk i kishte kontestuar këto dy lëndë për arsye të mos shkaktimit të kostove shtesë për komunën ngase pretendimet e palëve kreditore ishin të drejta.

Rreziku Vonesat në pagesa dhe mungesa e raportimit të të gjitha obligimeve në pasqyra financiare dhe raportet mujore ka rezultuar me ekzekutim të pagesave me urdhër përmbarimor duke krijuar kosto shtesë për buxhetin e komunës e shpeshherë edhe keqklasifikim të shpenzimeve. Pagesat e ekzekutuara në këtë mënyrë rrezikojnë fondet e projekteve të planifikuara.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen dhe paguhen brenda afateve ligjore për të shmangur mundësinë e kostove shtesë. Po ashtu, duhet shtuar kujdesin lidhur me mënyrën e menaxhimit të procesit të pranimit dhe regjistrimit të faturave.

Çështja C3 - Lidhja e kontratave në mungesë të fondeve (zotimeve) të mjaftueshme

Gjetja LMFP Nr. 03/L-221 neni 36.1 thotë se: Para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK në përputhje me rregullat KMF.

Kontrata "Ndërtimi i ndriçimit publik në Banjë" prej 56,811€ kishte mjete të zotuar 25,509€, ndërsa mjetet financiare të planifikuara për këtë projekt në buxhetin 2018 ishin 50,000€ dhe nuk kishte mjete të planifikuara për vitin 2019. Sipas zyrtarëve të komunës zotimi i mjeteve është bërë pjesërisht për shkak se financimi i projektit është planifikuar nga të hyrat vetanake, dhe mjetet do zotohen varësisht prej realizimit të të hyrave. Po ashtu, në pesë kontrata të mallrave e shërbimeve zotimi i fondeve nuk ishte i plotë para nënshkrimit të kontratës.

Rreziku Mungesa apo zotimet më të ulëta se vlera e kontraktuar me rastin e nënshkrimit të kontratave kanë ekspozuar komunën para një rreziku të hyrjes në obligime përtej shumës që tejkalon fondet e ndara dhe ndikon në prolongimin e realizimit të projekteve të planifikuara.

Rekomandimi C3 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetanake apo fonde tjera të financimit.

3.1.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1,000€) është 17,448,394€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1,000€) është prezantuar 249,000€.

Çështja A7 - Mangësi në regjistrat kontabël të pasurive

Gjetja Menaxhimi i pasurive rregullohet me rregulloren nr. 02/2013. Në menaxhimin e pasurive kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Në 6 raste kemi evidentuar se vlera prej 324,696€ ishte regjistruar sipas vlerës totale të kontratave/pagesave që janë bërë dhe jo sipas vlerës së projekteve të ndara. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 6.1 i Rregullores nr 02/2013. Pagesat kryesisht janë për asfaltimin e rrugëve dhe zgjerimin e infrastrukturës me destinim turizmin malor;
- Pasuritë nën 1,000€ për sektorin e Shëndetësisë dhe Arsimit nuk ishin të përfshirë në regjistrin E-pasuria; dhe
- Vlera prej 3,930€ për “Ndërtimin e shkallëve emergjente” ishte regjistruar si artikull i ri, ndonëse ishte përmirësim i pasurisë dhe duhej ti rritej vlera objektit në të cilin ishte bërë ky investimi Ky regjistrim nuk është në përputhje me nenin 15.2 të rregullores nr. 02/2013.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive të mjaftueshme të zyrtarit të pasurive me kërkesat e rregullores së Ministrisë së Financave dhe mos azhurnimit të regjistrit me kohë.

Rreziku Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon Komuna dhe ndikon në mbi apo nënvlerësimin e pasurive në pasqyra financiare vjetore. Kjo mund të ndikoj edhe në theksimin e çështjes së opinionit të auditimit.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të siguroj menaxhim efektiv të pasurive me qëllim që regjistri i pasurive të prezantoj gjendjen reale të pasurive, pra që vlera e pasurive të mos jetë e mbivlerësuar e as e nënvlerësuar. Po ashtu, duhet siguruar trajnime adekuate për zyrtarin e pasurive me qëllim që kompetenca të jetë në nivelin e duhur për të shmangur të gjitha paqartësitë me të cilat ballafaqohet zyrtari i pasurive gjatë evidentimit dhe menaxhimit të pasurive.

Çështja B4 -Vonesa në kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin të pasurive jo financiare**Gjetja**

Neni 24 i rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive kërkon që vetëm pasi të jetë bërë barazimi i gjendjes së inventarizimit dhe vlerësimin me gjendjen e pasurisë të prezantohet vlera e pasurisë në PVF.

- Komuna në fund të vitit kishte themeluar komisionet për inventarizim / vlerësim, mirëpo ky proces nuk kishte arritur të përfundonte plotësisht pasi që sektori i shëndetësisë deri sa ishim në auditim në fund të muajit shkurtit 2019 nuk e kishte kryer inventarizimin. Pra inventarizimi ishte jo i plotë dhe në disa drejtori ku kishte përfunduar kishte defekte të shumta. Për derisa vlerësimi i pasurive nuk ishte kryer ende gjatë kohës që ne ishim në ekzekutim të auditimit; dhe
- Komuna nuk kishte udhëzime të brendshme të aprovuara lidhur me inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive jo financiare kërkesë e nenit 19.5.3 dhe 21.5.3 i rregullores nr. 02/2013.

Kjo kishte ndodhur për shkak të neglizhencës dhe mungesës së njohurive të stafit të angazhuar në kryerjen e inventarizimit/vlerësimin të pasurive jo financiare dhe mungesës së udhëzimeve të brendshme të aprovuara lidhur me këtë proces.

Rreziku

Angazhimi jo i duhur për azhurnimin e regjistrit të pasurisë reflekton mungesë të informatave të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim. Kjo rritë rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet dhe njëherësh ndikon në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit plotësisht para përgatitjes së PFV-ve. Raporti duhet të përfshijë krahasimin e gjendjes fizike me atë në gjendjen e regjistrave. Nëse konstatohen diferenca ato duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.

3.2 Të arkëtueshmet

Komuna e Istogut ka prezantuar llogari të arkëtueshme në vlerë totale 1,069,080€ që kanë të bëjnë me: tatimin në pronë 1,049,880€ dhe leje ndërtimi 19,200€ ndërsa nuk ishin prezantuar në shpalosjet e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2018 ngarkesa për afarizëm të bizneseve 174,831€, ngarkesa për shërbime të pijeve alkoolike 8,380€, si dhe qiraja komunale me karakter të përkohshëm në vlerë 12,890€. Vlera reale e të arkëtueshmeve ishte 1,265,181€.

Çështja A8 - Rritje e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

- Gjetja** Komuna e Istogut nuk ka ndonjë plan operativ për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe nuk ka ndërmarr ndonjë veprim për arkëtimin e këtyre borxheve përmes përmbaruesve. Trendi i të arkëtueshmeve është në rritje të vazhdueshme nga viti në vit gjersa krahasuar me vitin paraprak janë rritur borxhet për rreth 7%. Rritja më e madhe ka ndodhur te tatimi në pronë. Shkaqet e rritjes së të arkëtueshmeve janë ndikuar nga mos veprimi i Komunës që lëndët t'i procedoj te përmbaruesi edhe pse disa përpjekje janë bërë që përmes vërejtjeve të rrisë mbledhjen e të arkëtueshmeve nga qiratë.
- Rreziku** Rreziku i mos inkasimit të të hyrave ndikon që shumë projekte kapitale të mos realizohet për shkak të mungesës së mjeteve. Mungesa e kontrollit dhe mos aplikimi i masave adekuate pamundëson arkëtimin dhe rrit rrezikun e vjetërimit të kërkesave.
- Rekomandimi A8** Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet ndërmerren veprime ligjore përmes përmbaruesve, kurse te qiramarrësit borxhli të ndërmerr masa për marrjen e objekteve dhe tokës që janë duke e shfrytëzuar dhe dhënien në shfrytëzim personave tjerë në përputhje me procedurat e ankandit publik.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 142,421€ e prezantuar në pasqyra financiare. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna.

Çështja B5 - Mungesa e raportimit dhe vonesa në pagesën e obligimeve të papaguara

Gjetja Neni 5.2 i Rregullës financiare nr. 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore thotë: “Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara. Raportimi, sipas kësaj rregulle financiare, bëhet përmes raporteve mujore”. Kemi evidentuar se komuna gjatë vitit 2018 nuk kishte raportuar obligimet e papaguara përmes raporteve mujore në Ministrinë e Financave-Thesar.

Neni 39 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike përcakton afatin e pagesës brenda 30 ditëve nga pranimi i faturës. Kemi evidentuar dy raste prej 15,438€¹¹ në të cilat komuna ishte vonuar nga 129 deri 145 ditë në pagesat e obligimeve ndaj furnitorëve.

Kjo gjendje ishte për shkak të neglizhencës së zyrtarit përgjegjës për raportimin e obligimeve të papaguara dhe për shkak të mungesës së procedurave të qarta formale për menaxhimin e procesit të pranimit, regjistrimit dhe raportimit të faturave.

Rreziku Mos raportimi i rregullt i të gjitha obligimeve në raportet mujore, paraqet pasqyrim jo të drejtë të obligimeve, dhe së bashku me vonesat në pagesa mund të ndikojë në rritjen e obligimeve të cilat krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerri veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave

¹¹ Fatura me dt. 28.12.2017 për Asfaltimin e rrugës Selman Tahirsylaj prej 14,715€; dhe Fatura me dt. 11.10.2017 për Dreka zyrtare prej 723€.

buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunes së Istogut veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, nuk janë të vendosura.

Të gjitha Komunitat janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent. Komuna e Istogut posedon këto plane strategjike: Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Istogut 2017-2021, Plani zhvillimor i komunës së Istogut 2018-2026 dhe Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2016 – 2021.

Megjithatë, ende nuk posedon “Hartën Zonale të Komunes” por vetëm është marrë vendimi për hartimin e saj me datën 04.06.2016, e që deri më tani nuk ka ndodhur hartimi i saj.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor në pozitën e drejtorit. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

NjAB ka hartuar Planin strategjik dhe vjetor të punës dhe Komiteti i Auditimit (KA) po ashtu ka mbajtur tri takime gjatë vitit 2018. Nga katër auditimet sa ishin planifikuar, tri janë përfunduar. Auditimet kanë mbuluar: menaxhimin e pasurisë, të hyrat dhe shpenzimet në drejtorin e shërbimeve publike dhe zyrën e prokurimit.

Çështja B6 – Funkcionimi i kufizuar i NJAB-së dhe KA-së

- Gjetja** Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së, si:
- Njësitë e audituara nuk kanë hartuar plane për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së dhe kjo ka rezultuar me një nivel të ulët të zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Nga gjithsej 20 rekomandimet e dhëna, shtatë ishin zbatuar, tetë ishin në proces të zbatimit ndërsa pjesa tjetër nuk është zbatuar ende. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet të zbatohen nga komuna me kohë; dhe
 - Komiteti i auditimit ka mbajtur tri (3) takime ku janë diskutuar raportet e NjAB dhe ZKA-së. Sidoqoftë, KA nuk ka qenë mjaftueshëm efektiv në përmbushjen e mandatit për të mbikëqyrur rezultatet e NjAB-së dhe ofrimit të kontributit në zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm nga menaxhmenti.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve zvogëlon efikasitetin dhe ndikimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm në përmirësimin e qeverisjes së përgjithshme.

Rekomandimi B6 Kryetari në bashkëpunim me KA-në dhe NjAB-së duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe të marrë të gjitha veprimet ndaj njërive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja B7 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

Gjetja Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Pavarësisht se linjat e llogaridhënies dhe të komunikimit ishin funksionale përmes takimeve të rregullta javore, formati aktual i raportimeve menaxheriale nuk ofron bazë për kontrolle të brendshme efektive meqenëse raportimi me shkrim tek menaxhmenti i lartë bëhet vetëm sipas kërkesës dhe jo në baza të rregullta kohore.

Komuna e Istogut nuk kishte hartuar regjistrin e rreziqeve sipas kërkesave të MFK-së, ku do të bëhej identifikimi i rreziqeve të pritshme kundrejt objektivave, përcaktimi i mënyrës së menaxhimit të tyre dhe njësitë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës dhe komunikimit të dobët në organizatë.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 të Komunës së Istogut ka rezultuar me 16 rekomandime kryesore. Komuna e Istogut kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet e dhëna. Megjithatë, nuk janë marrë veprime të mjaftueshme pasi që plani i veprimit nuk është zbatuar në tërësi dhe mangësitë e njëjta vazhdojnë të përsëriten në disa fusha.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, vetëm pesë rekomandime ishin zbatuar plotësisht, tri ishin në proces të zbatimit, ndërsa shtatë nuk janë zbatuar ende. Po ashtu një rekomandim ishte i mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, si dhe janë marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve si dhe te shpalojset e pasurisë. Të gjitha shpenzimet duhet të buxhetohen dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël. Me tutje, e gjitha pasuria, përfshirë pronat të cilat i posedojnë si dhe pasuritë jo financiare duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë.</p> <p>Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	<p>Komuna ka ndërmarrë masa lidhur me adresimin e pronave komunale, ka lidhur kontratë me një operator që do të bëjë rregullimin e pronave komunale duke përcaktuar edhe vlerën financiare të këtyre pronave por te regjistrimi ende nuk ka veprime dhe regjistrimi i pasurive në E-pasuria ende nuk ishte komplet. nuk kemi marrë ndonjë arsye konkrete lidhur me këtë çështje por keq klasifikimi i shpenzimeve mbetet ende sfide. Në këtë çështje kanë dalë edhe sfida tjera.</p>	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	<p>Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit me kohë dhe në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.</p>	Vazhdon e njëjta gjendje.	Rekomandimi i pazbatuar
3	Të hyrat	<p>Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave të paluajtshme për qëllim të tatimit në pronë duhet të bëhet sipas</p>	Menaxhmenti kishte marrë veprimet e	Rekomandimi i zbatuar

		rregullave, në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.	duhura për zbatimin e rekomandimit.	
4	Të hyrat	Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale të bëhet vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave. Gjithashtu, duhet të shqyrtohen në mënyra aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e dakorduara janë realizuar.	Janë marrë pak veprime në lidhje me ankandet por gjendja mbetet pothuaj e pandryshuar si problem.	Rekomandimi i pa zbatuar
5	Pagat dhe shtesat	Kryetari duhet të sigurojë se duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rast se ka nevojë për të punësuar shtesë në komunë (pozita të rregullta) të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, si dhe të gjitha pagesat për pagat e tyre të kalojnë përmes sistemit të pagave. Gjithashtu, pagesat sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta të realizohen vetëm pasi të sigurohen dëshmi të mjaftueshme për kryerjen e këtyre shërbimeve.	Ishin zhvilluar procedura të rekrutimit dhe kishte dëshmi të mjaftueshme për kryerjen e shërbimeve mbetet sfide kohëzgjatja e kontratave dhe kalimi i pagesës përmes sistemit të pagave.	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar
6	Investimet kapitale	Kryetari duhet të shtojë kontrollet për të siguruar se komuna disponon fondet e mjaftueshme para hyrjes në obligime kontraktuale dhe kërkesat për paramasat dhe paralogaritë janë specifikuar sipas nevojave dhe në përputhje me rregullat e prokurimit.	Nuk kemi identifikuar raste të ngjashme gjatë testimeve tona.	Rekomandimi i zbatuar

7	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet shtesë tek zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit. Fillimisht kriteret e përcaktuara duhet të jenë të qarta, e me pas të komisioni për vlerësim të ofertave të bëjë një vlerësim objektiv në përputhje me to.	Nuk kemi identifikuar raste të ngjashme gjatë testimeve tona.	Rekomandimi i zbatuar
8	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet shtesë për zbatimin e procedurës së konfiskimit të sigurisë së ofertës në rastet e përcaktuara me rregulla dhe Udhëzuesin operativ të prokurimit publik.	Nuk kemi identifikuar raste të ngjashme gjatë testimeve tona.	Rekomandimi i zbatuar
9	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se komuna merr obligime kontraktuale konform fondeve të buxhetuara vjetore dhe sipas rregullave. Kontrollet adekuate duhet të funksionojnë para nënshkrimit të kontratave e sidomos në periudhën e fund vitit.	Kemi raste kur nuk ka pasur zotime të mjaftueshme për kontratën dhe është lidhur në fund të vitit. Megjithatë nuk kemi evidentuar raste të ngjashme, që nënkuton që ka progres në këtë drejtim.	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar
10	Çështjet e përbashkëta për mallrat /shërbimet si dhe investimet Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit komisionet përkatëse formohen prej rastit në rast me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ, në përputhje me rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik.	Nuk kemi identifikuar raste të ngjashme gjatë testimeve tona.	Rekomandimi i zbatuar
11	Çështjet e përbashkëta për mallrat /shërbimet si dhe investimet Kapitale	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e pagesave për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e punëve/shërbimeve të kontraktuara.	Ka ende raste edhe gjatë vitit 2018 ku janë ekzekutuar pagesa në mungesë dëshmive të mjaftueshme.	Rekomandimi i pazbatuar

12	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit para përgatitjes së PFV-ve. Raporti duhet të përfshijë krahasimin e gjendjes fizike me atë në gjendjen e regjistrave. Nëse konstatohen diferenca ato duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.	Edhe këtë vit, inventarizimi dhe vlerësimi i pasurive jo financiare nuk ishte kryer me kohë.	Rekomandimi i pa zbatuar
13	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.	Nuk ka filluar zbatimin, por nevoja për zbatim është e pranishme.	Rekomandimi i pa zbatuar
14	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore apo tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Rekomandimi i mbyllur.	Rekomandimi i mbyllur
15	Qeverisja e mirë-Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari në bashkëpunim me KA-në dhe NjAB-së duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe të marrë të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.	Situata në këtë komponent mbetet e njëjtë.	Rekomandimi i pa zbatuar
16	Qeverisja e mirë - Raportimi	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha	Situata në këtë komponent mbetet e njëjtë.	Rekomandimi i pa zbatuar

		masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.		
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV- Ref. C1	<p>Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Në procesin e buxhetimit të gjitha shpenzimet duhet të buxhetuar në përputhje me planin kontabël. Më tutje, e gjitha pasuria, përfshirë pronat duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë. Po ashtu, shpalosjet e llogarive të arkëtueshme dhe detyrimet kontingjente duhet të jenë prezantuar në mënyrë të plotë dhe saktë në PVF-të për vitin 2019.</p> <p>Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>		
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit- Ref.B1	<p>Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit me kohë dhe në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.</p>		
3	Të hyrat - Ref. B2	<p>Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale të bëhet vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave. Gjithashtu, duhet të shqyrtohen në mënyra aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e dakorduara janë realizuar.</p>		
4	Pagat dhe mëditjet - Ref. C2	<p>Kryetari, duhet të siguroj ndërprerjen e një praktike të tillë të angazhimeve dhe për të gjitha pozitat e rregullta të punës për të cilat komuna ka nevoja afatgjata kërkesat t'i adresoj me rastin e planifikimit buxhetor, duke bërë kërkesë për rritje të stafit dhe t'i trajtoj dhe diskutoj me MF. Pagesat e tilla duhet kryer nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.</p>		
5	Pagat dhe mëditjet - Ref. A1	<p>Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë hapa konkret për përmirësimin e kontrolleve mbi dosjet e personelit në mënyrë që të gjitha dosjet të jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm. Kompletimi i dosjeve të behët brenda një afati tre mujor pas pranimit të këtij raporti.</p>		

6	Investimet kapitale - Ref. A2	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me punë të mos iniciohen pa u siguruar se ekziston edhe projekti ekzekutues. Parapërgatitjet e duhura për një projekt do të kenë ndikim edhe në hartimin e specifikimeve të qarta, por edhe do të eliminohen pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë.
7	Investimet kapitale - Ref. A3	Kryetari duhet të sigurojë që në asnjë rast nuk mund të ketë tejkalime të punëve shtesë mbi 10% nga kontrata origjinale dhe në rastin e punëve shtesë menaxheri i prokurimit duhet t'i ndjek të gjitha rregullat e prokurimit që kërkohen. Po ashtu, duhet të vendoset sistemi i llogaridhënies në rastet e ndryshimit të pozicioneve (prodhuesit) dhe vonesave të punimeve të paaprovuara. Një monitorim i vazhdueshëm i menaxhimit të proceseve të prokurimit është i domosdoshëm nga menaxhmenti, në rastet e projekteve komplekse.
8	Investimet kapitale - Ref. A4	Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i prokurimeve përfshirë procesin e vlerësimit ushtrohen në harmoni të plotë me kriteret e vendosura dhe ofertuesit që nuk janë në përshtatshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit të mos shpërblehen me kontratë. Po ashtu të aplikohet sistemi i llogaridhënies në rastet e mos kryerjes së punëve sipas kërkesave ligjore.
9	Investimet kapitale - Ref. B3	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e pagesave për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e punëve/shërbimeve të kontraktuara.
10	Investimet kapitale - Ref. A5	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë në njohuri me kërkesat e prokurimit publik, raportohet për çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës. Po ashtu, çdo ndryshim në kushtet e kontratës duhet të arsyetohet dhe aprovohet nga zyra e prokurimit dhe ZKA.
11	Çështjet e përbashkëta për MSH dhe IK Ref. A6	Kryetari duhet të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen dhe paguhen brenda afateve ligjore për të shmangur mundësinë e kostove shtesë. Po ashtu, duhet shtuar kujdesin lidhur me mënyrën e menaxhimit të procesit të pranimit dhe regjistrimit të faturave.
12	Çështjet e përbashkëta për MSH dhe IK Ref. C3	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetanake apo fonde tjera të financimit.
13	Pasuritë kapitale dhe jo-	Kryetari duhet të siguroj menaxhim efektiv të pasurive me qëllim që regjistri i pasurive të prezantoj gjendjen reale të pasurive, pra që vlera e pasurive të mos jetë e mbivlerësuar e as e nënvlerësuar. Po ashtu, duhet siguruar trajnime

	kapitale Ref. A7	adekuate për zyrtarin e pasurive me qëllim që kompetenca të jetë në nivelin e duhur për të shmangur të gjitha paqartësitë me të cilat ballafaqohet zyrtari i pasurive gjatë evidentimit dhe menaxhimit të pasurive.
14	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale Ref. B4	Kryetari duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit plotësisht para përgatitjes së PFV-ve. Raporti duhet të përfshijë krahasimin e gjendjes fizike me atë në gjendjen e regjistrave. Nëse konstatohen diferenca ato duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.
15	Llogaritë e arkëtuesh me Ref. A8	Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet ndërmerren veprime ligjore përmes përmbaruesve, kurse te qiramarrësit borxhli të ndërmerr masa për marrjen e objekteve dhe tokës që janë duke e shfrytëzuar dhe dhënien në shfrytëzim personave tjerë në përputhje me procedurat e ankandit publik.
16	Obligimet e papaguara - Ref. B5	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.
17	Sistemi i auditimit të brendshëm Ref. B6	Kryetari në bashkëpunim me KA-në dhe NjAB-së duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe të marrë të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.
18	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut - Ref. B7	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit

Gjetjet/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e Komunës në rast të mos pajtitimit	Pikëpamjet e ZKA-së
Çështja A2		Autoriteti kontraktues - Zyra e prokurimit ka proceduar për aktivitetin e prokurimit HARTIMI I PROJEKTEVE PER INFRASTRUKTURE (Njoftim për kontratë, date 07.03.2018). Për shkak të vonesave me ankesa të OE konkurrues dhe bazuar në shkresën zyrtare 01 NR. 344/2018, datë 27.06.2018, te Zyrtarit Kryesor Administrativ - ku kërkohet nga Zyra e prokurimit që të procedohet me aktivitete të prokurimit pa projekte zbatuese sepse deri në këtë datë zyra e prokurimit nuk ka procedu me aktivitete të prokurimit pa projekte zbatuese edhe pse kërkesat ishin të shumta nga njësitë kërkuese.	Në komentin e Komunës nuk mohohet e gjetura por jepen vetëm arsyetime pse ka ndodhur ngjarja, gjë të cilën edhe ne në draft e kemi sqaruar mjaftueshëm. Megjithatë ky shpjegim nuk e ndryshon gjendjen se kontratat janë lidhur pa projekt ekzekutiv siç është konstatuar te çështja 2. Prandaj rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.
Çështja A4		Pas sqarimeve të kërkuara nga OE ishte mundësuar nga AK që diplomat të jenë vetëm të noterizuara por të ofrohet së paku lista e pagave, e që edhe kjo listë mungonte.	Në dëshmitë që na janë ofruar nuk ndryshon e gjetura por vetëm është plotësuar. Prandaj rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.
Çështja A5		Nuk ka ndonjë koment vetëm disa pjesë të Udhëzuesit të prokurimit në lidhje me bartjen e përgjegjësisë te menaxheri i projektit, në lidhje me të gjeturën.	Sikur në UOPP-në ashtu edhe në përgjigjen e KRPP-së theksohet se ndryshimi i pozicioneve dhe sasive te kontratat jo kornizë mund të bëhen me pëlqimin e palëve por pas marrjes së aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ. Ne në rastin tonë nuk kemi aprovim nga Zyrtari Kryesor Administrativ. Prandaj rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.
Çështja B3:		Zyra e prokurimit, pas nënshkrimit të kontratës, dhe pas emërimit të menaxherit të projektit nga Zyrtari Kryesor Administrativ, menaxhimi i kontratës - përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë, do të kalojë nga Dep. i Prokurimit te Menaxheri i Projektit. Pra kjo e gjetur nuk është e lidhur me zyrën e prokurimit por me menaxher të kontratave.	Në komentin e Komunës nuk mohohet e gjetura por jepen disa shpjegime të cilat nuk janë relevante pasi nuk kundërshtohet e gjetura. Prandaj rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.

Çështja C3:		Lidhur me këtë çështje bashkëngjisim si shtojcë një përgjigje Nga KRPP. Pyetja 23. Në rastin e kontratave publike kornizë a jemi të obliguar që të bëjmë zotimin e mjeteve të tërësishme të planifikuara për atë aktivitet prokurimi?	Në komentin e Komunës jepen disa sqarime në lidhje me zotimin për kontratat kornizë përderisa kontrata e trajtuar në draftin e auditimit nuk ka të bëjë me kontratë kornizë, por me kontrata jo kornizë. Prandaj rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.
Çështja A3:		<p>Në rastin në fjalë nuk kemi punë shtesë. Pra kemi të bëjmë me punë të paparapara – pozicione të paparapara ku është shprehë konkurrencë pa publikim të njoftimit procedurë e kufizuar e negociuar, me emërim të komisionit nga Zyra e kryetarit për krahasim dhe vlerësim.</p> <p>-Kompania e kontraktuar për nënkontraktor i ka njoftuar palët në interes.</p> <p>- Për vonesat e realizimit të kontratës nuk ka pasi që fillimi dhe mbarimi i dinamikës është e sanksionuar në njoftimin për kontratë dhe në planin për menaxhimin e kontratës, plani dinamik i kontraktorit nuk ka qenë kërkesë e AK në legjislacionin dytësor e as kërkesë për vlerësim.</p>	<p>- Në titullin e kontratës vërehet qartë se kemi të bëjmë me aneks kontratë e cila i referohet një kontrate bazë dhe lidhet për punët e paparapara. Tejkalimi është evident siç është cekur në draft raport. Po ashtu, procedura e përdorur është e negociuar sipas nenit 35 të ligjit 04/L-042 pika 35.2.4 (i) e që ka të bëjë me aneks kontratë.</p> <p>- Njoftimi për punë që do të nënkontraktohen duhet të bëhet me rastin e ofertimit e jo pas lidhjes së kontratës.</p> <p>- Në kushtet e veçanta të kontratës është përcaktuar afati për realizimin e kontratës. Bazuar në këtë afat, vonesat në realizim janë evidente. Prandaj rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.</p>

Shtojca III: Letër Konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Istogut, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; (përpos disa sqarimeve dhe deshmive nga Zyra e Prokurimit Publik)si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Haki Rugova

Kryetar i Komunës së Istogut,

Data: 18.Prill.2019, Prishtinë,

